- Aparati bëhet shumë i nxehtë. Mos i prekni asnjëherë sipërfaqet e brendshme të nxehta të hapësirës së zierjes ose elementet nxehëse. Aparatin e leni gjithmonë të ftohet. Fëmijët i mbani larg.
- Pajisja ose ena bëhen shumë të nxehta. Enët ose pajisjet e nxehta i nxirrni nga hapësira për zierje gjithmonë me një leckë kuzhine.
- Avujt alkoolik mund të ndizen në hapësirën e nxehtë për zierje. Asnjëherë mos përgatitni gjellë me sasi të mëdha të pijeve që përmbajnë përqindje të lartë të alkoolit. Përdorni vetëm sasi të vogla të pijeve që përmbajnë përqindje të lartë të alkoolit. Derën e aparatit e hapni me kujdes.

Rrezik nga djegia!

- Pjesët e arritshme gjatë punës bëhen të nxehta. Mos i prekni asnjëherë pjesët e nxehta. Fëmijët i mbani larg.
- Gjatë hapjes së derës së aparatit mund ta dalë avull i nxehtë. Derën e aparatit e hapni me kujdes. Fëmijët i mbani larg.
- Në saje të ujit në hapësirën e nxehtë për zierje mund të formohet avull i nxehtë. Asnjëherë mos derdhni ujë në hapësirën e nxehtë për zierje.

Rrezik nga lëndimi!

Qelqi i gërvishtur i derës së aparatit mund të pëlcasë. Mos përdorni kruese qelqi, mjete të serta ose fërkuese për pastrim.

Rrezik nga goditja e rrymës!

- Riparimet e gabuara janë të rrezikshme. Riparimin guxon ta bëjë vetëm një teknik i shkolluar në shërbimin tonë të klientëve Nëse aparati është në defekt, hiqeni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave Thirrni shërbimin e klientëve
- Në pjesët e nxehta të aparatit izolimi i kabllos së aparateve elektrike mund të shkrihet. Kabllon e lidhjes së aparateve elektrike asnjëherë mos e sillni në kontakt me pjesët e nxehta të aparatit.
- Lagështia që depërton mund të shkaktojë një goditje të rrymës. Mos përdorni pastrues me presion ose pastrues me avull.
- Gjatë ndërrimit të llambës së hapësirës për zierje kontaktet e fasungës kanë rrymë. Para ndërrimit hiqeni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave.
- Një aparat me defekt mund të shkaktojë një goditje të rrymës. Asnjëherë mos e ndizni një aparat me defekt. Hiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën në arkën e siguresave. Thirrni shërbimin e klientëve

Shkaqet e dëmtimeve

Kujdes!

- Pajisje, fletë, letër për pjekje ose enë në dyshemenë e hapësirës për zierje Mos shtroni pajisje në dyshemenë e hapësirës për zierje. Dyshemenë e hapësirës për zierje mos e shtroni me asnjë fletë pa marrë parasysh e cilit lloj, dhe as me letër për pjekje. Mos vendosni enë në dyshemenë e hapësirës për zierje, nëse është rregulluar një temperaturë mbi 50 °C. Krijohet një pengesë e ngrohtësisë. Më nuk do të jetë e saktë koha e pjekjes dhe skuqjes dhe do të dëmtohet emali.
- Uji në hapësirën e nxehtë për zierje Asnjëherë mos derdhni ujë në hapësirën e nxehtë të zierjes. Kështu krijohet avull uji. Nga ndryshimet e temperaturës shkaktohen dëmtime të emalit.
- Ushqime të lëngshme: Mos ruani ushqime të lëngshme për kohë më të gjatë në hapësirën për zierje të mbyllur. Do të dëmtohet emali.
- Lëng pemësh: Te ëmbëlsirat e pemëve me shumë lëng, tepsinë për pjekje mos e mbushni shumë. Lëngu i pemëve, i cili pikon nga tepsia e pjekjes, krijon njolla, të cilat pastaj nuk largohen. Nëse është e mundur, përdorni tiganin e thellë universal.
- Ftohje me derën e hapur të aparatit: Hapësira për zierje lihet të ftohet vetëm në gjendje të mbyllur. Edhe nëse dera e aparatit është e hapur vetëm për një dhëmb, ballinat mobilieve fqinje me kalimin e kohës mund të dëmtohen.
- Shtupësi i derës i ndotur fortë Nëse shtupësi i derës është shumë i ndotur, dera e aparatit gjatë punës më nuk mund të

mbyllet si duhet. Ballinat e mobilieve fqinje mund të dëmtohen. Shtupësin e derës e mbani gjithmonë të pastër.

- Dera e aparatit si sipërfaqe për ulje ose si vend për vendosje: Mos vendosni, ulni, ose varni në derën e aparatit. Mos vendosni enë ose pajisje mbi derën e aparatit.
- Futja e pajisjeve: Varësisht nga tipi i aparatit pajisja gjatë mbylljes mund ta gërvishtë fletën e derës së aparatit. Pajisjen gjithmonë e futni në hapësirën për zierje deri në një goditje.
- Transportimi i aparatit: Mos e mbartni ose lëvizni aparatin duke e kapur për dorezën e derës. Doreza e derës nuk e mban peshën e aparatit, andaj dhe mund të thyhet.

Furra juaj e re

Këtu do të njiheni me furrën tuaj të re. Do t'ju shpjegojmë panelin e komandimit dhe secilin nga elementët e komandimit.

Do të merrni gjithashtu informacione për dhomëzën e gatimit dhe aksesorët.

Paneli i përdorimit

Këtu do të gjeni një vështrim të përgjithshëm të panelit të komandimit. Funksionimi varet nga çdo tip i caktuar pajisjeje.



Shpjegimet	
1	Zgjedhësi i funksioneve
2	Zgjedhësi i temperaturës
3	Alarmi

Zgjedhësi i funksioneve

Me anë të zgjedhësit të funksioneve, rregulloni llojin e ngrohjes për furrën. Zgjedhësi i funksioneve mund të rrotullohet djathtas ose majtas.

Kur është vendosur lloji i dëshiruar i ngrohjes, llamba e furrës do të ndizet.

Rregullimi		Funksioni
0	Fikur	Furra është e fikur.
	Ngrohje e sipërme/e poshtme	Pjekja dhe thekja është e mundur vetëm në një plan. Për kekët dhe picat në forma ose në tavë si dhe për copat e holla të mishit të lopës, viçit dhe mishit të egër, ky rregullim është i përshtatshëm. Nxehtësia vjen njëtrajtshmërisht si lart ashtu edhe poshtë.

* Lloji i ngrohjes është në përputhje me normat EN 50304.

Rregullimi		Funksioni
	Ajër i nxehtë*	Në një nivel mund të përgatisni mafishe dhe ëmbëlsira me brumë sfoliat. Ëmbëlsirat e vogla, amaretat dhe ëmbëlsirat me brumë sfoliat mund t'i piqni njëkohësisht në dy nivele. Ventilatori në pjesën e pasme të pajisjes e shpërndan ngrohtësinë që vjen nga lart dhe poshtë njëtrajtshmërisht në gatesa.
	Pjekja në skarë e gatesa të sheshta, sipërfaqe e madhe	Mund të piqni në skarë më shumë biftekë, salsiçe, peshq dhe toste. E gjithë sipërfaqja nën elementin nxehës të skarës do të nxehet.
	Rrjeta e qarkullimit të ajrit	Pjekja në skarë me qarkullim ajri është veçanërisht e përshtatshme për për pjekjen në skarë të peshkut, shpendëve dhe copave të mëdha të mishit. Elementi nxehës dhe ventilatori ndizen dhe fiken me alternim. Ventilatori e shpërndan ajrin e nxehtë mbi gatesa.

* Lloji i ngrohjes është në përputhje me normat EN 50304.

Zgjedhësi i temperaturës

Me zgjedhësin e temperaturës mund ta rregulloni temperaturën dhe shkallën e skarës

Pozitat		Funksioni
•	Fikur	Furra nuk nxehet.
50-270	Zona e temperaturës	Të dhënat e temperaturës në °C.
1, 2, 3	Shkallët e skarës	Shkallët e skarës për skarën, me sipërfaqe ▭ të madhe. Shkalla 1= e dobët Shkalla 2 = e mesme Shkalla 3 = e fortë

Kur furra nxehet, llambëza mbi zgjedhësin e temperaturës ndriçon. Në pauzat e nxehjes shuhet. Te disa rregullime ajo nuk ndriçon.

Shkallët e skarës

Tek pjekja e rrafshët në skarë ▭ me zgjedhësin e temperaturës rregulloni një shkallë skare.

Zilja

Zilen mund ta rregulloni deri në 60 minuta . Zilja punon në mënyrë të pavarur prej furrës. Ajo mund të përdoret si një zile e kuzhinës.

Pozicioni		Funksioni
•	Zero-pozicioni	Rregullimi fikur
🔔	Përfundimi i kohës së rregulluar	Sinjali pas përfundimit të kohës së rregulluar
🔔 - 60	Treguesi i minutave	Treguesi i kohës, në Minuta.

Kështu rregulloni

Rregulloni zilen në kohëzgjatjen e dëshiruar.

Koha ka mbaruar

Pasi të përfundojë koha, tingëllon një sinjal. Ndërprerësi vetë rrotullohet në pozitën i fikur •.

Dhomëza e gatimit

Llamba e furrës ndodhet në dhomëzën e gatimit. Ventilatori e mbron furrën nga mbinxehja.

Llamba e furrës

Llamba e furrës ndriçon gjatë punës së furrës. Duke e rrotulluar zgjedhësin e funksioneve në pozicionin e dëshiruar llamba e furrës mund të ndizet gjithashtu, edhe kurë furra nuk nxehet.

Ventilatori ftohës

Ventilatori ndizet dhe fiket sipas nevojës. Ajri i ngrohtë del përmes derës.

Që hapësira për zierje pas punës më shpejtë të ftohet, ventilatori do të ecë për një kohë të caktuar më tej.

Kujdes!

Vrimën për ajrosje mos e mbuloni. Përndryshe furra do të stërnxehet.

Pajisja e juaj

Pajisja e juaj e bashkëdërguar është e përshtatshme për shumë gjellë. Kini kujdes në atë, që pajisjen gjithmonë ta futni si duhet në hapësirën për zierje.

Që disa gjellë të bëhen më të mira ose manovrimi me furrën tuaj të re të bëhet akoma më i rehatshëm, ekziston një zgjidhje e pajisjeve të veçanta.

Futja e aksesorit

Aksesorin mund ta futni në 4 lartësi të ndryshme në furrë. Shtyjeni gjithmonë mirë deri sa të mbërthehet, në mënyrë që të mos e prekë xhamin e derës.



Kur aksesori është nxjerrë pothuajse deri në mes, mbërthehet. Tani mund t'i nxirrni lehtësisht gatesat.

Kur e futni në furrë, bëni kujdes buzën e dalë në pjesën e pasme të aksesorit. Vetëm kështu mund të mbërthehet mirë.



Udhëzim: Aksesori mund të shformohet nga nxehja. Sapo të jetë ftohur, aksesori do të marrë sërish formën e tij. Funksionimi nuk ndikohet.

Mbani tepsinë në të dyja anët me të dy duart dhe futeni atë paralelisht në skarë. Gjatë futjes së tepsisë në furrë ikni lëvizjeve djathtas apo majtas. Ndryshe, tepsia vështirë mund të futet në furrë tepsia. Sipërfaqet e emaluara mund të dëmtohen.

Pajisjen mund ta bleni më pas te shërbimi për klientë, në dyqane të specializuara ose përmes internetit. Ju lutemi shënoni HEZ-Numrin.

	Skara Për enë, kallëpe ëmbëlsirash, mish i skuqur, copa mishi në skarë dhe gjellëza të ngrira. Futeni skarën me pjesën e hapur në derën e furrës dhe kurbaturën nga poshtë.
	Tigani universal Për ëmbëlsira të lëngshme, të pjekura, ushqime të ngrira dhe skuqje të mëdha. Tigani mund të përdoret gjithashtu dhe si akumullues i yndyrës, nëse skuqni direkt mbi skarë. Futeni tiganin universal me kanalin nga ana e derës së furrës.

Aksesorë të veçantë

Aksesorët e veçantë mund t'i blini pranë shërbimit të klientit ose në dyqanet e specializuar. Në broshurat tona ose në internet do të gjeni produkte të përshtatshme për furrën tuaj. Disponueshmëria dhe mundësia për t'i blerë këta aksesorë të veçantë përmes internetit ndryshon në varësi të vendit. Informacionet përkatëse do t'i gjeni në dokumentet e shitjes.

Jo çdo aksesor i veçantë i përshtatet çdo pajisjeje. Kur e blini, jepni gjithmonë emrin e plotë (E-Nr.) të pajisjes tuaj.

Aksesorë të veçantë	HEZ Nummer (Numri i prodhimit)	Funksioni
Skara	HEZ 434000	Për enë, kallëpe ëmbëlsirash, mish të pjekur, copa mishi në skarë dhe gatesa të ngrira.
Tava e pjekjes prej alumini	HEZ 430001	Për kekë dhe gurabije. Futeni tavën e pjekjes në furrë me pjesën e pjerrët nga ana e derës së furrës.
Tavë pjekjeje e emaluar	HEZ 431001	Për kekë dhe gurabije. Futeni tavën e pjekjes në furrë me pjesën e pjerrët nga ana e derës së furrës.
Tava universale	HEZ 432001	Për ëmbëlsira të lëngshme, pasta, gatesa të ngrira dhe mish rosto të madh. Mund të përdoret edhe për të pritur pikimet e yndyrës ose lëngut të mishit nën skarë. Futeni tavën universale në furrë me pjesën e pjerrët nga ana e derës së furrës.

Dera e furrës - masat plotësuese të sigurisë

Gjatë kohës së gjatë të zierjes, dera e furrës mund të nxehet shumë.

Nëse keni fëmijë të vegjël, gjatë punës me furrë preferohet një nivel më i lartë i kujdesit .

Përveç kësaj, në dispozicion është një pajisje mbrojtëse, e cila e pengon prekjen e drejtpërdrejtë të derës së furrës. Kjo pajisje e veçantë (440651) gjendet në shërbimin e klientëve.

Para përdorimit të parë

Këtu do të kuptoni se çka duhet bërë, para se për herë të parë me furrën tuaj të përgatitni gjellë. Lexoni së pari kapitullin *Udhëzime mbi sigurinë*.

Nxeheni furrën

Me qëllim të evitimit të erës së re të keqe, nxehni furrën e zbrazët dhe të mbyllur. Ideale për këtë është një orë me nxehësin e epërm-/poshtëm me 240 °C. Kini kujdes në atë, që në hapësirën për zierje të mos ketë mbetje nga paketimi.

Ajroseni kuzhinën, për sa kohë furra nxehet.

1. Me zgjedhësin e funksioneve e rregulloni nxehësin e epërm-/e poshtëm .
2. Me zgjedhësin e temperaturës rregulloni në 240 °C.

Furrën e fikni pas një ore. Për këtë zgjedhësin e funksioneve e rrotulloni në pozicionin zero.

Pastrimi i pajisjeve shtesë

Para se ta përdorni pajisjen shtesë për herë të parë, pastroni atë mirë me mjet larës dhe me rizë të butë për pastrim.

Rregullmi i furrës

Ju keni mundësi të ndryshme për të bërë rregullimin e furrës suaj. Këtu do të ju sqarojmë, se si taë rregulloni mënyrën e dëshiruar të nxehjes dhe temperaturën ose shkallën e skarës.

Mënyrat e nxehjes dhe temperatura

Shembull në fotografi: Nxehësi i epërm-/i poshtëm 190 °C

1. Me zgjedhësin e funksioneve e rregulloni mënyrën e dëshiruar të nxehjes.



2. Me zgjedhësin e temperaturës mund ta rregulloni temperaturën ose shkallën e skarës



Furra do të nxehet.

Fikja e furrës

Zgjedhësin e funksioneve e çoni në pozicionin zero

Ndërrimi i rregullimeve

Mënyra e nxehjes, temperatura dhe shkalla e skarës mund të ndërrohen sipas nevojës.

Mirëmbajtja dhe pastrimi

Në rast se kujdeseni dhe e pastroni furrën tuaj si duhet, ajo do të jetë në gjendje të mirë dhe funksionale për një kohë të gjatë. Më poshtë do t'ju shpjegojmë sesi të kujdeseni dhe si ta pastroni furrën tuaj si duhet.

Udhëzime

- Disa materiale të ndryshme, si pjesët prej qelqi, plastike ose metali në pjesën ballore të furrës mund të pësojnë çngjyrosje të lehta.
- Hijet në xhamin e derës, që duken si vija, janë reflekset e dritës së llambës së furrës.
- Si pasojë e temperaturave shumë të larta, shtresa e emalit digjet. Për këtë arsye mund të krijohen çngjyrosje të vogla. Kjo është normale dhe nuk ka asnjë ndikim në funksionim. Qoshet e tavave të holla nuk emalohen plotësisht. Për këtë arsye mund të jenë të ashpra. Mbrojtja nga gërryerja nuk do të ndikohet nga kjo.

Mjet për pastrim

Me qëllim që sipërfaqet e ndryshme të mos dëmtohen nga lëndët e ndryshme pastruese, merrni parasysh të dhënat në vijim.

Gjatë pastrimit të furrës

- kurrfarë lëndësh të ashpra apo fërkuese për pastrim,
- kurrfarë lëndësh pastruese me përqindje të lartë të alkoolit,
- as sfungjerë për fërkim,
- as pastrues me presion të lartë ose pastrues me avull.
- Pjesët e veçanta të mos pastrohen në pjatalarëse.

Sfungjerët e ri i lani mirë para përdorimit të parë.

Ballinat nga çeliku i fisnikëruar	Aparatin e fshini me ujë dhe pak mjet shpëlarës Fshini gjithmonë paralel me strukturën natyrale. Përndryshe mund të shkaktohen gërvishtje. Thani me një leckë të butë. Njollat e gëlqeres, yndyrës, shtirakut dhe të bardhës së vesë i largoni menjëherë. Mos përdorni mjete për fërkim, sfungjerë që gërvishtin apo lecka të vrazhda për pastrim. Pjesët e përparme nga çeliku i fisnikëruar mund t'i lustroni me ndihmën e një mjeti special për mirëmbajtje. Përfillni udhëzimet e prodhuesit. Pastruesin special të çelikut të fisnikëruar e gjeni në shërbimin tonë të klientëve ose në treg.
sipërfaqet e emaluara dhe ato të lyera me llak	i fshini me mjet shpëlarës dhe ujë të ngrohtë Thani me një leckë të butë.
Sustat	i fshini me mjet shpëlarës dhe ujë të ngrohtë Thani me një leckë të butë.
Fleta e qelqit	Mund të pastrohet me një pastrues qelqi. Mos përdorni mjete agresive për pastrim apo sende të mprehta metalike. Këto mund ta gërvishtin dhe dëmtojnë sipërfaqen e qelqit.
Shtupës	Të fshihet me një leckë të butë. Thani me një leckë të butë.
Pjesa e brendshme e furrës	Pastroni me ujë të ngrohtë apo ujë me uthull. Kur ka ndotje të mëdha: Pastruesi për furrë të përdoret vetëm në sipërfaqet e ftohura.
Mbulesa e qelqtë e llambës së furrës	i fshini me mjet shpëlarës dhe ujë të ngrohtë Thani me një leckë të butë.
Pajisje	Zbutni në këllirë të ngrohtë. Pastroni me një furçë ose me një sfungjer.

Tepsia për pjekje nga alumini (opsion)	Mos i pastroni në pjatalarëse. Asnjëherë mos përdorni pastrues për furrë. Me qëllim tu shmangemi gërvishtjeve, asnjëherë mos i prekni sipërfaqet metalike me thikë apo me ndonjë send të fortë. Pastroni horizontalisht me pak mjet shpëlarës me një leckë të lagët për pastrim të qelqit ose leckë prej mikro fibrash . Thani me një leckë të butë.Mos përdorni mjete për fërkim, sfungjerë që gërvishtin ose lecka të vrazhda për pastrim. Ata e gërvishtin tepsinë
Pajisja për sigurinë e fëmijëve (zgjedhje)	Nëse është e vendosur një pajisje për sigurinë e fëmijëve, ajo duhet të hiqet para pastrimit. Të gjitha pjesët prej plastike i zbutni në këllirë të ngrohtë dhe i fshini me sfungjer. Thani me një leckë të butë. Kur është shumë e ndotur, pajisja për sigurinë e fëmijëve nuk funksionon më si duhet.
Zona e zierjes	Udhëzime për mirëmbajtje dhe pastrim do të gjeni në udhëzimin për përdorim për sobën tuaj.

Montimi dhe çmonitimi i kornizës

Për pastrim mund ta heqni kornizën. Furra duhet të jetë e ftohur.

Zhvarja e mbështetësit:

1. Mbështetësin e nxirrni poshtë dhe e tërhiqni pak nga para. Kunjat vazhdues që gjenden në zonën e poshtme të mbështetësit i nxirrni jashtë nga vrimat përforcuese (Pasqyrimi A).
2. Në fund mbështetësin e palosni lartë dhe me kujdes e nxirrni jashtë (Pasqyrimi B).





Pastroni kornizën me mjet pastrues dhe me sfungjer për shpëlarje. Përdorni një furçë për ndotje të forta.

Varja e mbështetësit:

1. Të dy grepat i vendosni me kujdes në vrimat e epërme. (Pasqyrimi A-B)





⚠ **Montim i gabuar!**

Mbështetësin mos e lëvizni asnjëherë, para se të dy grepat të jenë ankoruar plotësisht në vrimat e epërme. Emali mund të dëmtohet dhe thyhet (pasqyrimi C).



2. Të dy grepat duhet të jenë varur plotësisht në vrimat e epërme. Tani mbështetësin ngadalë dhe me kujdes e lëvizni nga poshtë dhe e varni në vrimat e poshtme (pasqyrimi D).
3. Të dy mbështetësit i varni në muret anësore të furrës (pasqyrimi E).

Te mbështetëset e montuara drejtë distanca ndërmjet dy lartësive të epërme të futjes është më e madhe.





Montimi dhe çmonitimi i derës së furrës

Për ta pastruar dhe për të hequr disqet e vogla të derës dera e furrës mund të çmontohet.

Nyjet e derës së shporetit kanë nga një levë mbyllëse. Nëse levët mbyllëse janë të palosura (Fotografia A), dera është e siguruar. Atëherë nuk mund të çmontohet. Nëse nyjet e derës janë të çpalosura për çmontimin e derës së furrës (Fotografia B), levët mbyllëse janë të siguruara. Ata nuk mund të klikojnë.





⚠ **Rrizik nga lëndimi!**

Nëse levët mbyllëse nuk janë të siguruara, palosni ata me më tepër forcë. Mbani llogari, që levët mbyllëse të jenë gjimon të palosura deri në fund, respektivisht gjatë çmontimit të jenë krejtësisht të çpalosura.

Nxirr derën

1. Derën e furrës e hapni plotësisht.
2. Shpallos të dy levët për mbyllje, në të djathtë dhe në të majtë (Fotografia A).
3. Mbyll derën e furrës deri në fund. Kape me të dy duart majtas dhe djathtas. Mbylle edhe më tej dhe nxirre (Fotografia B).





Montimi i derës

Dera e furrës montohet sipas udhëzimeve por në rënditje të kundërt.

1. Gjatë montimit të derës së furrës të kini kujdesë, që të jenë të vendosura të dy nyjet në hapjet përkatëse si në (Fotografia A).
2. Nivelet duhet të jenë të njëjta nga të dyja anët (Fotografia B).





3. Të dy levët mbyllëse sërish të palosen (Fotografia C). Mbyllja e derës së furrës



⚠ Rrizik nga lëndimi!

Nëse dera e furrës bie pa qëllim ose është çpalosur një levë, mos prekni gjë. Thirni shërbimin e klientëve.

Montimi dhe çmontimi fletëve të derës

Për pastrim më të mirë fletët e qelqit në derën e furrës mund ti çmontoni.

Çmontimi

1. Derën e furrës e varni dhe me dorezën nga poshtë e vendosni në një leckë.
2. Mbulesën lartë të derës së furrës e hiqni. Për këtë gjuhëzën e shtypni me gishta majtas dhe djathtas (Fotografia A).
3. Fletën e epërme e ngreni dhe e hiqni (Fotografia B).





4. Fletën e ngreni dhe e hiqni (Fotografia C).



Fletët i pastroni me pastrues qelqi dhe me një leckë të butë.

⚠ Rrezik nga lëndimi!

Qelqi i gërvishtur i derës së aparatit mund të pëlcasë. Mos përdorni kruese qelqi, mjete të serta ose fërkuese për pastrim.

Montimi

Gjatë montimit kini kujdes, që mbishkrimi “right above“ majtas poshtë të qëndrojë në kokë.

1. Fletën e futni pjerrtas nga prapa (Fotografia A).
2. Fletën e epërme e futni pjerrtas nga prapa në të dy mbajtësit. Sipërfaqja e lëmuar duhet të jetë jashtë. (Fotografia B).





3. Vendosni mbulesën dhe e shtypni.
4. Varja e derës së furrës.

Furrën do ta përdorni përsëri, kur fletët të jenë montuar si duhet.

Një pengesë, çfarë duhet bërë?

Nëse paraqitet një pengesë, shpeshë herë ndodh të jetë diçka e vogël. Para se të thirni shërbimin e klientëve, shikoni së pari tabelën. Ndoshta do ta mënjanoni pengesën vetë.

Tabela e pengesave

Nëse me ndonjë gjellë nuk mund t'ia dilni, lexoni udhëzimin *. Gjellët i kemi testuar në studion tonë të gatimit*. Këtu do të gjeni këshilla dhe informacione të dobishme për zierje, pjekje dhe skuqje.

Siguresa në arkën e siguresave në defekt.	Shkaqet e mundshme	Mënjanimi i pengesave/ Informacione
Furra nuk funksionon.	Siguresa është në defekt.	Shikoni në arkën e siguresave, mos vallë është defekt siguresa.
	Rënie e rrymës.	Kontrolloni, se a funksionon llamba e kuzhinës respektivisht aparatet tjera të kuzhinës.
Furra nuk nxehet.	Pluhur në pjesët e kontaktit.	Dorezat e ndërprerësve i rrotulloni disa herë djathtas dhe majtas.

⚠ Rrezik nga goditja e rrymës!

Riparimet e bëra jashtë rregullave janë të rrezikshme. Riparimet mund të bëhen vetëm nga tekniku u shërbimit tonë të klientëve.

Kujdes!

Nëse kablloja e rrjetit dëmtohet, ajo duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, shërbimi i klientëve, ose ndonjë person i kualifikuar ngjashëm.

Ndërrimi i llambës së furrës në mbulesë

Nëse llamba e furrës është djegur, atëherë duhet të ndërrohet. Llambat për ndërrim rezistente ndaj temperaturës, 40 Vat, do ti gjeni te shërbimi i klientëve ose në shitoret e specializuara. Përdorni vetëm këto llamba.

⚠ Rrezik nga goditja e rrymës!

Fikni siguresën ne arkën e siguresave.

1. Për të shmangur dëmtimet, vendosni në furrën e ftohtë leckën e enëve.
2. Hiqni mbulesën e qelqtë duke rrotulluar në të majtë.



3. Llambën e ndërroni me llambë të njëjtit tip.
4. Mbulesën e qelqtë e vidhosni përsëri.
5. Leckën e kuzhinës e nxirrni dhe siguresën e ndizni.

Mbulesa e qelqtë

Mbulesa e qelqtë e dëmtuar duhet të ndërrohet. Mbulesat përkatëse të qelqit do ti gjeni në shërbimin e klientëve. Shënoni E-Numrin dhe FD-Numrin të pajisjes tuaj.

Shërbimi i klientëve

Nëse pajisja juaj duhet të riparohet, shërbimi jonë për klientët qëndron në dispozicionin tuaj. Ne gjithmon gjejm një zgjidhje të përshtatshme, gjithashtu për të evituar vizita të panevojshme nga ana e teknikut.

E-numri dhe FD- numri

Gjatë thirrjes jepni numrin e prodhimit (E-Nr.) dhe numrin e ekzekutimit (FD-Nr.), që të mund të kujdesemi profesionalisht për ju. Etiketën e tipit me numrat e gjeni, anash në derën e furrës. Që në rast nevoje mos të kërkoni gjatë, këtu mund t'i bartni të dhënat e aparatit tuaj dhe numrat e telefonit të shërbimit të klientëve.

E-Nr.	FD-Nr.

Shërbimi i klientëve ☏

Kini kujdes, se vizita e teknikut të servisit në rast të përdorimit të gabuar edhe brenda kohës së garancisë nuk është pa kosto.

Të dhënat e kontaktit për të gjitha vendet i gjeni në listën e përmbajtjes të shërbimit të klientëve.

Kini besim te kompetenca e prodhuesit. Kështu mund të jeni të sigurt se riparimin do ta realizojnë teknikët e trajnuar për riparim, të cilët janë të pajisur me pjesë këmbimi origjinale për pajisjet tuaja.

Këshilla për energjinë dhe mjedisin

Këtu mund të gjeni këshilla, sesi të kurseni energji gjatë gatimit ose pjekjes dhe sesi ta mënjanoni pajisjen siç duhet.

Kursimi i energjisë

- Furrën e paranxehni vetëm atëherë, kur kështu është dhënë në recetë ose në tabelën e udhëzimit për përdorim.
- Përdorni kallëpe të errëta për pjekje, të lyera me llak të zi apo të emaluara. Ata e thithin nxehtësinë në mënyrë të veçantë.
- Gjatë zierjes, skuqjes ose pjekjes, derën e furrës e hapni sa më rrallë që është e mundur.
- Më shumë ëmbëlsira më së miri i piqni njëra pas tjetrës. Furra është ende e nxehtë. Me këtë shkurtohet kohëzgjatja e pjekjes për ëmbëlsirën e dytë. Mund të futni gjithashtu 2 kallëpe kuti pranë njëri tjetrit.
- Te kohët më të gjata të zierjes, furrën mund ta fikni 10 minuta para përfundimit të kohës për zierje dhe ngrohtësinë e mbetur ta shfrytëzoni për mbarimin e plotë të zierjes.

Hedhja sipas normave ekologjike

Hidheni paketimin sipas normave ekologjike.

Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Masat që duhet t'i kemi parasysh gjatë transportit

Përforconi të gjitha pjesët e lëvizshme brenda dhe mbi aparat me shirit ngjitës, i cili mund të hiqet pa lënë ndonjë gjurmë. Pjesë të caktuara të pajisjeve (p.sh. tepsinë për pjekje) për ta parandaluar dëmtimin e aparatit vendosni në sirtarët përkatës me karton të hollë në skaje. Vendosni një karton apo diçka të ngjashme mes anës së përparme dhe të pasme, për të ndaluar goditjen nga ana e brendshme në qelqin e derës. Derën e furrës me një shirit ngjitës e përforconi për muret anësore të aparatit.

Ruani paketimin origjinal të aparatit. Aparatin transportoni vetëm në paketimin origjinal. Merrni parasysh shigjetat e transportit në paketim.

Nëse paketimi origjinal nuk është në dispozicion

Paketoni aparatin në një paketim të mbrojtur, për të garantuar një mbrojtje të mjaftueshme nga dëmtimet gjatë transportit.

Transportoni aparatin në pozitë vertikale. Mos e kapni aparatin për dorëze të derës apo për lidhjet e anës së prapme, sepse ato mund të dëmtohen. Mos vendosni sende të rënda mbi aparat.

Për ju të testuara në studion tonë të gatimit

Këtu do të gjeni një zgjidhje gjellësh dhe rregullimet optimale për to. Ne do të ju tregojmë, se cila mënyrë e nxehjes dhe temperaturë është më e përshtatshme për gjellën tuaj. Do të merrni të dhëna për pajisje të përshtatshme dhe se në cilën lartësi do të duhet të futen. Do të merrni këshilla për enë dhe për përgatitje.

Udhëzime

- Vlerat në tabela vlejnë gjithmonë për futje në hapësirën për zierje të ftohtë dhe të zbrazët.

  Paranxehni vetëm nëse është dhënë në tabela. Pajisjen e shtroni me letër për pjekje tek pas paranxehjes.
- Të dhënat kohore në tabela janë vlera orientuese. Ato varen nga kualiteti dhe nga cilësia e ushqimeve.
- Përdorni pajisjen e bashkëdërguar. Pajisjet plotësuese i gjeni si pajisje të veçanta në shitore të specializuar ose në shërbimin e klientëve.

  Para përdorimit nxirrni pajisjet dhe enët e panevojshme nga hapësira për zierje.
- Përdorni gjithmonë një leckë mbrojtëse, kur nga hapësira për zierje të nxirrni pajisje ose enë të nxehta.

Ëmbëlsirat dhe biskotat

Pjekja në një nivel

Te pjekja e ëmbëlsirave dhe tortave nxehësi i epërm-/i poshtëm ⊟ i jep rezultatet më të mira.

Gjatë pjekjes me 2D ajrin e nxehtë ⊠ pajisjen e futni në lartësitë e futjes si më poshtë:

- Ëmbëlsira në kallëpe ëmbëlsirash: Lartësia e futjes 2
- Ëmbëlsira në tepsi për ëmbëlsira: Lartësia e futjes 3

Pjekja dhe skuqja në më shumë nivele

Përdorni ajrin e nxehtë ⊠.

Lartësitë e futjes te pjekja dhe skuqja në 2 nivele:

- Tigani universal: Lartësia e futjes 3
- Tepsia për pjekje: Lartësia e futjes 1

Gjellët e futura në të njëjtën kohë në furrë, nuk do të thotë se edhe në të njëjtën kohë do të jenë gati.

Në tabela do të gjeni një zgjedhje të gjellëve.

Udhëzim: Ushqimet mos i vendosni direkt mbi tavën e aluminit. Tavën e aluminit shtrojeni me letër kuzhine.

Kallëpe për pjekje

Më të përshtatshëm janë kallëpet nga metali.

Te përdorimi i kallëpeve për pjekje nga metali me mure të holla dhe kallëpet e qelqit zgjaten kohët e pjekjes dhe ëmbëlsira nuk skuqet në mënyrë të barabartë.

Nëse dëshironi të përdorni kallëpe nga silikoni, orientohuni sipas të dhënave dhe recetave të prodhuesit. Kallëpet nga silikoni shpesh janë më të vogla se kallëpet normale. Sasitë e brumit dhe të dhënat në receta mund të devijojnë.

Tabelat

Në tabela do të gjeni mënyrën optimale të nxehjes për ëmbëlsira të ndryshme dhe të pjekura. Temperatura dhe kohëzgjatja e pjekjes varen nga sasia dhe cilësia e brumit. Për këtë në tabela janë dhënë zona. Provojeni së pari me vlerën më të ulët. Një temperaturë e ulët jep një skuqje më të barabartë. Nëse është e nevojshme herën tjetër rregulloni më lartë.

Nëse paranxehni, kohën e pjekjes, e shkurtoni për 5 deri 10 minuta.

Informacione plotësuese do të gjeni nën*këshilla për pjekjen* në aneks të tabelave.

Ëmbëlsira në kallëpe	Kallëp	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, minuta
Ëmbëlsira të përziera të thjeshta	Kallëp tas-/ kurorë-/ kuti	2		160-180	50-60
Ëmbëlsira të përziera fine (p. sh. ëmbëlsirë rëre)	Kallëp tas-/ kurorë-/ kuti	2		155-175	65-75
Fund brumi të brydhët me rreth	Kallëp çmontues	1		160-180	30-40
Fund torte nga brumi i përzier	Kallëp për fund peme	2		160-180	25-35
Tortë biskotash	Kallëp çmontues	2		160-180	30-40
Tortë me pemë ose me gjizë, brumi i brydhët*	Kallëp çmontues i errët	1		170-190	70-90
Ëmbëlsira pemësh fine, nga brumi i përzier	Kallëp çmontues	2		150-170	55-65
Ëmbëlsira pikante* (p.sh. pite/ëmbëlsirë qepësh)	Kallëp çmontues	1		180-200	50-60

* Ëmbëlsirat i leni në aparat rreth 20 minuta të ftohen.

Ëmbëlsira në tepsi	Pajisje	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, minuta
Brumë tharmi ose i përzier me shtesë të thatë	Tigani universal:	3		160-180	25-35
Brumë tharmi ose i përzier me shtesë të lëngshme	Tigani universal:	3		140-160	40-50
Rolat biskote (paranxehni)	Tigani universal:	2		170-190	15-20
Bisht tharmi me 500 g miell	Tigani universal:	3		150-170	25-35
Kek, 500 g miell	Tigani universal:	3		160-180	50-60
Kek, 1 kg miell	Tigani universal:	3		150-170	90-100
Shtrudël, e ëmbël	Tigani universal:	2		180-200	55-65
Pica	Tigani universal:	3		180-200	20-30

Bukë dhe bukëza

Nëse nuk është thënë ndryshe për pjekjen e bukës furrën e paranxehni gjithmonë.

Mos derdhni asnjëherë ujë, direkt në furrën e nxehtë.

Bukë dhe bukëza	Pajisje	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, minuta
Bukë tharmi, 1,2 kg miell	Tigani universal:	2		270 190	8 35-45
Bukë bajate, 1,2 kg miell	Tigani universal:	2		270 190	8 35-45
Bukëza (p.sh. bukëza thekre)	Tigani universal:	2		200-220	20-30

Të pjekura të vogla	Pajisje	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, minuta
Ëmbëlsira të vogla	Tigani universal:	3		150-170	10-20
	Tepsia për pjekje nga alumini* + tigani universal**	1+3		130-150	25-35
Mafishe	Tigani universal:	3		70-90	125-135
Krofne	Tigani universal:	2		200-220	30-40
Makrone	Tigani universal:	3		110-130	30-40
	Tepsia për pjekje nga alumini* + tigani universal**	1+3		100-120	35-45
Brumë jufkash	Tigani universal:	3		180-200	20-30
	Tepsia për pjekje nga alumini* + tigani universal**	1+3		180-200	30-40

* Tepsia plotësuese do të gjeni në shërbimin e klientëve ose në dyqane të specializuara.

** Te pjekja në dy nivele, gjithmonë tiganin universal e futni mbi tepsi.

Këshilla për pjekje

Dëshironi të piqni sipas recetës tuaj personale.	Orientohuni sipas të pjekurave të ngjashme në tabelat e pjekjes.
Kështu do të konstatoni nëse ëmbëlsira e përzier është pjekur mirë.	Rreth 10 minuta para përfundimit të kohës së pjekjes të dhënë në recetë, ngulni një kruese dhëmbësh në pjesën më të lartë të ëmbëlsirës. Nëse në kruese nuk ngjitet më brumë, ëmbëlsira është gati.
Ëmbëlsira ulet.	Herën tjetër përdorni më pak lëng ose uleni temperaturën e furrës për 10 gradë. Vini re kohët e përzierjes të dhëna në recetë.
Ëmbëlsira në mes është më e fryrë, ndërsa në skaje më e ulët.	Mos i lyeni me yndyrë skajet e kallëpit çmontues. Pas pjekjes, me një thikë lironi ëmbëlsirën me kujdes.
Ëmbëlsira sipër bëhet tepër e errët.	Futeni më thellë atë, zgjidhni një temperaturë më të ulët dhe piqeni ëmbëlsirën ca më gjatë.
Ëmbëlsira është tepër e thatë.	Në ëmbëlsirën e gatshme me kruese dhëmbësh shponi vrima të vogla. Pastaj mbi te derdhni lëng pemësh ose pije alkoolike. Herën tjetër zgjidhni temperaturë për 10 gradë më të lartë dhe shkurtoni kohët e pjekjes.
Buka ose ëmbëlsira (p.sh. . ëmbëlsira me djathë) ka pamje të mirë, por brenda është e qullët (e përshkuar me vija uji).	Herën tjetër përdorni më pak lëng dhe me temperaturë më të ulët piqni ca më gjatë. Te ëmbëlsirat me shtesa të lëngshme, piqni më parë fundin. Shtrojeni me bajame ose thërrmija buke dhe pastaj qiteni shtesën për sipër. Përfillni ju lutemi recetat dhe kohët e pjekjes.
Të pjekurat janë të skuqura në mënyrë jo të barabartë.	Zgjidhni temperaturë ca më të ulët, atëherë të pjekurat do të skuqen në mënyrë ca më të barabartë. Të pjekurat delikate i piqni me nxehësin e epërm dhe të poshtëm ▭ në një nivel. Dalja e letrës për pjekje jashtë tepsisë, ndikon në qarkullimin e ajrit. Letrën për pjekje e preni gjithmonë në pajtim me madhësinë e tepsisë.
Ëmbëlsira nga pemët është shumë e çelë nga poshtë.	Herën tjetër ëmbëlsirën futeni një nivel më thellë.
Lëngu i pemëve po noton mbi.	Herën tjetër e përdorni tiganin universal më të thellë (nëse e posedoni).
Gjatë pjekjes së bukëzave prej tharmi, copat ngjiten së bashku.	Ndërmjet bukëzave duhet të mbahet një distancë prej rreth 2 cm. Kështu do të ketë vend të mjaftueshëm, që bukëzat të mund të vijnë dhe të piqen njëlloj.
Dëshironi të piqni në dy nivele.	Gjatë pjekjes në më shumë nivele përdorni përherë ajrin e nxehtë ♨. Gjellët e futura në të njëjtën kohë në furrë, nuk do të thotë se edhe në të njëjtën kohë do të jenë gati.
Gjatë pjekjes së ëmbëlsirave të lëngshme formohet ujë i kondensuar.	Gjatë pjekjes mund të formohet avull uji. Ai largohet nëpërmjet derës. Avulli i ujit mund të ngjitet në zonën drejtuese ose në ballinat e mobilieve të afërta dhe të pikoj si ujë i kondensuar. Kjo është fizikisht e kushtëzuar.

Mish, shpezë, peshk

Enë

Mund të përdorni çdo enë rezistente ndaj temperaturës. Për pjekje të mëdha është i përshtatshëm edhe tigani universal.

Më i përshtatshëm është ena nga qelqi. Kini kujdes në atë, që kapaku të i bëjë tamam skuqësit dhe të mbyllet mirë.

Nëse përdorni enë të emaluara, shtoni më tepër masë të lëngshme.

Për enët nga çeliku i fisnikëruar skuqja nuk do të jetë shumë e fortë dhe mishi mund të jetë i zier më pak. Zgjatni kohët e zierjes.

Të dhënat në tabela:
Enë pa kapak = e hapur
Enë me kapak = e mbyllur

Enën e vendosni gjithmonë në mes të skarës.

Enët e nxehta nga qelqi i vendosni në një nënshtrojë të thatë. Nëse shtroja është e lagur ose e ftohtë, qelqi mund të pëlcasë.

Skuqja

Mishit pa dhjam shtoni edhe pak ujë brenda. Fundi i enës duhet të jetë ½ cm afërsisht i mbushur.

Mishit që piqet me avull shtoni ujë brenda në enë. Fundi i enës duhet të jetë 1 - 2 cm i mbuluar.

Sasia e lëngut varet nga lloji i mishit dhe nga materiali i enës. Nëse e përgatitni mishin në tavë të emajluar, nevoitet pak më tepër lëng, se sa në enë qelqi.

Enët nga çeliku janë kushtimisht të përshtatshme. Mishi zihet ngadalë dhe skuqet më pak. Përdorni temperaturë më të madhe dhe/ose leni të zihet më gjatë.

Udhëzime për pjekje në skarë

Piqni në skarë gjithmonë me furrë të mbyllur.

Paranxehni skarën për rreth 3 minuta, para se copat e mishit t'i vëni në skarë.

Vendosni copat e mishit drejtpërdrejtë në skarë. Një copë e vetme mishi bëhet më e mirë nëse e vendosni në mes të skarës. Futeni në mënyrë plotësuese një tigan universal në lartësinë 1. Lëngu i mishit do të mblidhet dhe furra mbetet e pastër.

Tepsia për pjekje dhe tigani universal nuk lejohet të futen në lartësinë 4. Gjatë temperaturave të larta mund të deformohen dhe gjatë nxjerrjes ta dëmtojnë hapësirën për zierje.

Gjithmonë merrni copa mishi për skarë mundësisht me madhësi të njëjtë. Në këtë mënyrë ato skuqen në mënyrë të barabartë dhe ngelin bukur të lëngshme. Stekat i kriposni tek pasi të jenë pjekur në skarë.

Rrotulloni copat e mishit sipas ⅔ kohës së dhënë.

Trupi nxehës i skarës herë ndizet e herë fiket. Kjo është normale. Sa shpesh do të ndodh kjo, varet nga shkalla e rregulluar i skarës.

Mish

Kthejini copat e mishit pas gjysmës së kohës.

Kur pjekja është gati, duhet të qëndrojë edhe 10 minuta të tjera në furrë të fikur dhe të mbyllur. Në këtë mënyrë lëngu i mishit mund të shpërndahet më mirë.

Pasi ta keni zier, mbështilleni mishin rosto me letër alumini dhe lëreni atë 10 minuta në qetësi brenda në furrë.

Në copat e mishit të derrit me lëkurë priteni lëkurën në formë kryqesh dhe vendoseni të piqet në enë fillimisht me lëkurë nga poshtë.

Mishi	Pesha	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura °C, shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Mish gjedhi						
Të skuqura gjedhi	1,0 kg	mbyllur	2		200-220	120
	1,5 kg		2		190-210	140
	2,0 kg		2		180-200	160
Filet gjedhi, rozë	1,0 kg	hapur	1		210-230	70
	1,5 kg		1		200-220	80
Biftek, rozë	1,0 kg	hapur	1		230-250	50
Steka, 3 cm, rozë		Skarë + tigan universal	4+1		3	15
Mish viçi						
Të skuqura viçi	1,0 kg	hapur	1		200-220	100
	1,5 kg		1		190-210	120
	2,0 kg		1		180-200	140
Mish derri						
pa lëkurë (p.sh. . qafë)	1,0 kg	hapur	1		190-210	120
	1,5 kg		1		180-200	150
	2,0 kg		1		170-190	170
me lëkurë (p. sh. . shpatulla)	1,0 kg	hapur	1		180-200	130
	1,5 kg		1		190-210	160
	2,0 kg		1		170-190	190
Brinjë derri me koc	1,0 kg	mbyllur	1		210-230	80
Mish qengji						
Kofsha qengji pa koc, medium	1,5 kg	hapur	1		170-190	120
Mish i bluar						
Të skuqura nga mishi i bluar	rreth 750 g	hapur	1		180-200	70
Salsiçe						
Salsiçe		Skarë + tigan universal	4+1		3	15

Shpend

Vlerat e tabelës vlejnë për futje në furrë të ftohtë.

Të dhënat e peshës në tabelë i referohen shpendëve të pambushur, të gatshëm për skuqje.

Nëse piqni direkt në skarë, futeni tiganin universal në lartësinë 1.

Te rosat dhe patat lëkurën nën fletë e shponi, ashtu që yndyra të mund të kulloj.

Shpendët i vendosni në skarë me anën e gjoksit nga poshtë. Pas dy të tretës së kohës shpendët e tërë i ktheni.

Shpendi skuqet veçanërisht shijshëm, nëse pak para se të përfundojë koha e skuqjes e lyeni me gjalpë, ujë të kripur ose lëng portokalli.

Shpend	Pesha	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura °C, Shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Gjysma pule, 1 -4 copa	nga 400g	Skara	2		210-230	40-50
Pjesë pule	nga 250 g	Skara	3		210-230	30-40
Pulë, e tërë 1 -4 copa	secila nga 1 kg	Skara	2		200-220	55-85
Rosë, e tërë	1,7 kg	Skara	2		170-190	80-100
Patë, e tërë	3,0 kg	Skara	2		160-180	110-130
Zog bibe, i tërë	3,0 kg	Skara	2		180-200	80-100
2 kofsha miske	nga 800g	Skara	2		180-200	80-100

Peshk

Copat e peshkut i ktheni pas ⅔ kohës së dhënë.

Peshqit e tërë nuk është patjetër të rrotullohen. Futni në furrë peshkun e tërë në pozicion noti, me fletën e shpinës nga lartë. Vendosni në pjesën e barkut një gjysmë patateje, ose një enë të vogël të qëndrueshme në furrë, me qëllim që peshku të qëndrojë më stabil.

Gjatë pjekjes direkt me skarë, futni në mënyrë plotësuese tiganin universal në skarë në lartësinë 1 . Lëngu i peshkut do të mblidhet dhe furra mbetet e pastër.

Peshk	Pesha	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura °C, Shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Peshk, i tërë	nga 300 g	Skara	3		2	20-25
	1,0 kg	Skara	2		190-210	40-50
	1,5 kg	Skara	2		180-200	60-70
Peshk në feta, p.sh. kotëletë	nga 300 g	Skara	4		2	20-25

Këshilla për pjekje dhe tiganisje

Për peshën e rostos në tabelë nuk ka të dhëna.	Zgjidhni të dhënat sipas peshës më të ulët të radhës dhe zgjasni kohën.
Dëshironi të kontrolloni, nëse është rostoja gati.	Përdorni termometrin për mish (është në dispozicion në dyqanin e specializuar) ose bëni “provën me lugë“. Shtypni me lugë mbi roston. Nëse është i fortë, është atëherë gati. Nëse shtypet lehtë, atëherë i duhet edhe më tepër kohë.
Rostoja ka marrë ngjyrë te errët dhe korja vende-vende është djegur.	Kontrolloni lartësinë e elementit vendosës dhe temperaturën.
Rostoja duket mirë, por salca është djegur.	Herën tjetër zgjidhni një enë pjekjeje më të vogël ose shtoni më tepër lëng.
Rostoja duket mirë , por salca e ka ngjyrën e çelë dhe është e lëngshme.	Herën tjetër zgjidhni një enë pjekjeje më të madhe ose përdorni më pak lëng.
Gjatë derdhjes së rostos shkaktohet avull uji.	Kjo është dukuri fizike dhe normale. Pjesa më e madhe e avullit të ujit largohet përmes daljes për avull. Avulli mund të ngjitet në pjesën e përparme të tabelës së kontrollit ose në pjesën e përparme të mobiljeve në afërsi dhe të pikoj si ujë i kondensuar.

Tava, gratina, toste

Nëse piqni direkt në skarë, futni në mënyrë plotësuese tiganin universal në lartësinë 1. Furra ngelë më e pastër.

Vendosni enën gjithmonë në skarë.

Gjendja e zierjes së një tave varet nga madhësia e enës dhe lartësia e tavës. Të dhënat në tabela janë vetëm vlera orientuese.

Gjella	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Të dhënat e temperaturës në °C	Kohëzgjatja, minuta
Tava					
Tavë, e ëmbël	Kallëp tave	2		170-190	50-60
Tavë jufkash	Kallëp tave	2		210-230	25-35
Gratin					
Gratin patatesh prej erëzash natyrale Lartësia maks. 2 cm	Kallëp tave	2		150-170	50-60
Tost					
Skuqje tosti, 12 copa	Skara	4		3	4-5
Toste me kaçkavall, 12 copa	Skara	3		3	5-8

Produkte të gatshme

Përfillni të dhënat e prodhuesit në paketim.

Nëse pajisjen e shtroni me letër për pjekje, kini kujdes në atë, që letra për pjekje të jetë e përshtatshme për këtë temperaturë. Madhësinë e letrës ia përshtatni gjellës.

Rezultati i zierjes është shumë i varur nga ushqimi. Paraskuqjet dhe pa barabarësitë mund të jenë të pranishme që në lëndën e parë.

Gjella	Pajisje	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, minuta
Shtrudël me mbushje pemësh	Tigani universal:	3		180-200	40-50
Pomfriti	Tigani universal:	3		210-230	25-30
Pica	Skarë	2		200-220	15-20
Pica-baget	Skarë	2		190-210	15-20

Udhëzim

Gjatë zierjes së ushqimeve të ngrira tigani universal mund të deformohet. Shkaku për këtë qëndron në dallimet e mëdha të temperaturës, të cilave ju nënshtrohet pajisja. Deformimi zhduket përsëri që gjatë procesit të zierjes.

Gjellët speciale

Brumi i tharmit dhe kosi mund të përgatiten shumë mirë në temperatura të ulëta.

Largoni pajisjen nga furra.

Parapërgatitja e kosit

1. Zieni 1 litër qumësht (3,5 % yndyrë), në 40 °C lëreni të ftohet.
2. Qitni në qumësht 150 g kos (nga frigoriferi) dhe përzieni mirë.
3. qiteni atë në gota të vogla qelqi që mund të mbyllen dhe mbuloni me fletë për mbajtje freskët.
4. Gotat i vendosni në skarë dhe i futni në lartësinë 1.
5. Temperaturën e pjekjes e rregulloni në 50 °C dhe siç është dhënë vazhdoni më tej.

Brumi i tharmit lihet që të vjen

1. Brumin e tharmit e përgatitni si zakonisht, qiteni atë në një enë të qeramikës rezistente ndaj nxehtësisë dhe mbulojeni.
2. Furrën e paranxehni siç është dhënë.
3. Derën e furrës e mbyllni dhe brumin e tharmit e leni në furrë të vjen.

Gjella	Enë		Mënyra e nxehjes	Temperatura	Kohëzgjatja
Kos	Gota kosi që mund të mbyllen	1		50 °C	6-8 orë
Brumi i tharmit lihet që të vjen	Enët rezistente ndaj nxehtësisë	i vendosni në dyshemenë e furrës		paranxehni në 50 °C Aparatin e fikni dhe brumin e tharmit e vendosni në furrë	5-10 minuta 20–30 minuta

Shkrirja

Kohët e shkrirjes varen nga lloji dhe sasia e ushqimit.

Përfillni ju lutemi, të dhënat e prodhuesit, që gjenden në paketim.

Ushqimet nxirren nga paketimi dhe në një enë të përshtatshme vendosen në skarë.

Shpendët i vendosni në pjatë me anën e gjoksit nga poshtë.

Gjëra të ngrira	Pajisja	Lartësia	Mënyra e nxehjes	Temperatura
p.sh. torte me krem, torte me krem e gjalpë, torte me çokollatë ose glazurë sheqeri, fruta, pula, salsiçe dhe mish, bukë, bukëza, ëmbëlsira dhe të pjekura të tjera	Skara	2		Zgjedhësi i temperaturës ngel i fikur

Të thara

Përdorni vetëm pemë dhe perime pa të meta dhe lani mirë ato.

Pemët dhe perimet i leni të pikojnë mirë dhe i thani.

Tigani universal duhet të futet në lartësinë 3, skara në lartësinë 1.

Tiganin universal dhe skarën e shtroni me letër për pjekje ose pergamene.

Ktheni më shumë herë, pemët ose perimet shumë të lëngshme. Të tharat ndani nga letra menjëherë pas tharjes.

Pemë dhe perime	Lartësia	Mënyra e nxehjes	Temperatura, °C	Kohëzgjatja, orë
600g unaza molle	1+3		80	rreth 5
800g të çara dardhe	1+3		80	rreth 8
1,5 kg kumbulla ose xhenarika	1+3		80	rreth 8–10
200 g bar kuzhine, i pastruar	1+3		80	rreth 1½

Akrilamidi në ushqime

Akrilamidi krijohet kryesisht te produktet e drithit dhe patateve që përgatiten në temperatura të larta si p. sh patatinat, pom friti, tostet, bukëzat, buka ose të pjekura fine (gurabijet, biskotat me mjaltë, spekulatius).

Këshilla për përgatitjen e gjellëve me përmbajte të vogël akrilamidi.	
Në përgjithësi	■ Kohët e zerjes i mbani sa më të shkurta. ■ Gjellët piqini sa të marrin ngjyrë të verdhë në të artë, nuk duhet të marrin ngjyrë kafe. ■ Sa më e madhe dhe sa më e trashë të jetë gjella, aq më pak akrilamid përmban.
Pjekja	Me nxehësin e epërm-/poshtëm max. 200 °C. Me 3D-ajrin e nxehtë ose ajrin e nxehtë max. 180 °C.
Gurabije	Me nxehësin e epërm-/poshtëm max. 190 °C. Me 3D-ajrin e nxehtë ose ajrin e nxehtë max. 170 °C. Vezët ose e verdha e vezëve e zvogëlon formimin e akrilamidit.
Pomfrit furre	Shpërndaheni gjellën në tepsi në mënyrë të njëtrajtshme dhe me një shtresë. Që pomfriti të mos thahet, piqni të paktën 400 g për tepsi

Gjellë për testim

Këta tabela janë bërë për institutet e kontrollit për ta lehtësuar kontrollimin dhe testimin e aparateve të ndryshme.

Sipas EN 50304/EN 60350 (2009) përkatësisht IEC 60350.

Pjekja

Pjekja në 2 nivele:
Tiganin universal e futni gjithmonë mbi tepsinë për pjekje.

Të pjekura të lyera (si ëmbëlsira të lyera në shurup sheqeri):
Gjellët e futura në të njëjtën kohë në furrë, nuk do të thotë se edhe në të njëjtën kohë do të jenë gati.

Ëmbëlsira të mbuluara me mollë, në lartësinë 1:
Ndërroni pozicionin e kallëpit të errët çmontues, futni në mënyrë diagonale.
Ëmbëlsira të mbuluara me mollë, lartësia 2:
Ndërroni pozicionin e kallëpit të errët çmontues.

Ëmbëlsira në kallëp çmontues nga metali:
Me nxehësin e epërm-/të poshtëm piqni në lartësinë 1. Në vend të skarës përdorni tiganin universal dhe mbi të e vendosni kallëpin çmontues.

Gjella	**Pajisje dhe enë**	**Lartësia**	**Mënyrë e nxehjes**	**Temperatura, °C**	**Kohëzgjatja, minuta**
Biskotë e lyer	Tigani universal:	3		150-170	20-30
	Tepsia për pjekje nga alumini* + tigani universal**	1+3		140-160	30-40
Gurabije të vogla	Tigani universal:	3		150-170	25-35
Keksë të vegjël, paranxehni*	Tepsia për pjekje nga alumini* + tigani universal**	1+3		140-160	25-35
Biskota uji	Kallëp çmontues	2		160-180	30-40
Ëmbëlsira me mollë të mbuluara	Tigani universal + 2 kallëp çmontues Ø 20 cm**	1		190-210	70-80
	2 skara* + 2 kallëp çmontues Ø 20 cm***	1+3		180-200	70-80

* Tepsia plotësuese dhe skara do të gjeni si pajisje plotësuese në shërbimin e klientëve ose në dyqane të specializuara.
** Te pjekja në dy nivele, gjithmonë tiganin universal e futni mbi tepsi.
*** Kallëpet për ëmbëlsira i vendosni në pajisje në mënyrë diagonale.

Pjekja në skarë

Nëse ushqimet vendosen direkt në skarë, futni në mënyrë plotësuese tiganin universal në lartësinë 1. Lëngu do të mblidhet dhe furra do të ngelë e pastër.

Gjella	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehjes	Shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Skuqje tosti * 10 min. paranxehni	Skara	4		3	½-2
Qofte me mish lope (Beefburger), 12 copë* pa paranxehje	Skara + tigani universal	4+1		3	25-30

* Pas ⅔ së kohës ktheni.

Sadržaj

Važne napomene za sigurnost ... **36**
Uzroci oštećenja ... 37
Vaša nova rerna ... **38**
Polje sa komandama ... 38
Birač funkcija ... 38
Birač za temperaturu ... 38
Časovnik ... 39
Pećnica ... 39
Vaš pribor ... **39**
Uguravanje pribora ... 39
Specijalan pribor ... 40
Pre prvog korišćenja ... **40**
Zagrevanje rerne ... 40
Čišćenje pribora ... 40
Podešavanje rerne ... **40**
Vrste zagrevanja i temperatura ... 40
Nega i čišćenje ... **41**
Sredstva za čišćenje ... 41
Otkačivanje i zakačivanje okvira ... 41
Otkačivanje i zakačivanje vrata na rerni ... 42
Demontaža i ugradnja stakla na vrata ... 43
Smetnja, šta činiti? ... **43**
Tabela smetnji ... 43
Zamena sijalice na svodu u rerni ... 43
Stakleni poklopac ... 44
Tablica smetnji ... **44**
E-broj i FD-broj ... 44
Saveti za energiju i životnu sredinu ... **44**
Ušteda energije ... 44
Rešavanje otpada u skladu sa zaštitom okoline ... 44
Mere koje se moraju poštovati tokom transporta ... 44
Za Vas testirano u našoj kuhinji ... **45**
Kolači i peciva ... 45
Saveti za pečenje ... 46
Meso, živina, riba ... 47
Saveti za prženje i pečenje roštilja ... 48
Gužvare, đuveč, tostovi ... 49
Gotovi proizvodi ... 49
Specijalna jela ... 49
Topljenje ... 50
Sušenje voća i povrća ... 50
Akrimalid u namirnicama ... **50**
Probna jela ... **51**
Pečenje ... 51
Roštilj ... 51

Ostale informacije o proizvodima, priboru, rezervnim delovima i servisima ćete naći na internetu: **www.bosch-home.com** i "online" prodavnici: **www.bosch-eshop.com**

⚠ Važne napomene za sigurnost

Pažljivo pročitajte ovo uputstvo. Jedino tako možete sigurno i pravilno da rukujete Vašim uređajem. Sačuvajte uputstvo za upotrebu i montažu za neku kasniju upotrebu ili za sledećeg vlasnika.

Ovaj uređaj je namenjen samo za ugradnju. Obratite pažnju na specijalno uputstvo za montažu.

Pošto ste ga raspakovali, proverite uređaj. Ukoliko oštetio prilikom transporta, nemojte ga priključivati.

Samo ovlašćeni stručnjak sme da priključuje uređaje bez utikača. U slučaju štete zbog pogrešnog priključka ne postoji zahtev za garancijom.

Ovaj uređaj je namenjen za privatno domaćinstvo i kućno okruženje. Uređaj koristite samo za pripremu jela i pića. Nadzirite uređaj tokom rada. Uređaj koristite samo u zatvorenim prostorijama.

